



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1005/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Red Mill” SH.P.K, me NUI: ..., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “New Prishtina Residence” SH.P.K, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.516/21 të datës 01.12.2021 të Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “New Prishtina Residence” SH.P.K, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.516/21 i datës 01.12.2021, i të Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Red Mill” SH.P.K, ka caktuar urdhrin P.nr.516/21 të datës 01.12.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.18-454 të datës 05.07.2021, me të cilin është detyruar debitori që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 18,880.00 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturës, e gjerë në pagesën definitive të borxhit kryesor dhe kamatës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, duke u ekzekutuar me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës në llogarinë e veçantë të Përmbartuesit Privat, ose përmes regjistrimit të aksioneve në pronësi të debitorit dhe të letrave me vlerë në shoqëritë tregtare, si dhe kapitalin themelues ose kapitalin shtesë në një kompani aksionare apo çfarëdo forme tjetër ligjore të biznesit, apo përmes regjistrimit, vlerësimit, sekuestrimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtu që nga shitja e realizuar të

përbushet dhe shlyhet borxhi kryesor i debitorit , kamata ligjore si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore së bashku me tarifën e efikasitetit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbartimore nuk është e pranuar nga debitori ku dhe shihet në faturë se debitori nuk e ka nënshkruar dhe as pranuar, andaj, nuk ka i ka tiparet e dokumentit të besueshëm, ku lidhur me këtë LPP-ja si shkak të prapësimit në nenin 71.1.1 ka paraparë se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Tutje ka theksuar se lidhur me këtë rast po ashtu Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin CML.nr.24/2017 ka vendosur se faturat të cilat nuk janë të nënshkruara nga debitori nuk mund të jenë dokument i besueshëm dhe titull ekzekutiv. Po ashtu, ka theksuar se Përmbartuesi Privat gjatë procedurës përmbartimore është lëshuar në parregullsi gjatë kryerjes së procedurës së përmbartimore duke mos i dhënë mundësi debitorit që të paraqes mjetin juridik dhe ka vepruar kundër dispozitave të LPP-së dhe LPK-së, ngase veprimet e Zyrës Përmbartimore në rastin konkret nuk janë arsyetuar fare nga ana e Zyrës Përmbartimore, dhe e njëjta i ka tërhequr mjetet financiare nga xhirollogaria bankare debitorit duke i shkaktuar dëme të pariparueshme. Andaj, ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, dhe të anulohet urdhri përmbartimor i lartcekur, si dhe të obligohet kreditori që ti paguajë të gjitha shpenzimet të cilat i janë shkaktuar debitorit në këtë procedurë, duke përfshirë edhe prapësimin e përpiluar nga avokati në shumën prej 208 € sipas tarifës së OAK-së.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se urdhri përmbartimor i lartcekur i Përmbartuesit Privat është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datën 22.12.2021. Tutje ka theksuar se prapësimi-ankesa e debitorit është i pas afatshëm, e po të ishte brenda afatit, arsyet e prapësimit nuk i referohen kërkesave nga neni 71 të LPP-së, i cili përcakton saktë shkaqet për prapësim eventual. Pra, ky fakt prapësimin e bënë jo lëndor dhe si i tillë duhet të hedhet nga gjykata, ngase vetëm kur prapësimi përmban ndonjërin nga arsyet e cekura në nenin 71 të LPP-së, mund të trajtohet nga gjykata si i lejuar. Po ashtu, ka theksuar se fatura në bazë të së cilës është caktuar përmbartimi, si dokument i besueshëm i përmban të gjitha elementet e kërkuara me dispozita ligjore, andaj e ka fuqinë e dokumentit të besueshëm dhe drejtë është vendosur kur mbi

bazën e saj është caktuar përmbartimi, ngase e njëjta përmban të gjitha elementet e nevojshme që të identifkohet si dokument publik afarist. Gjithashtu, ka theksuar se për faturën e lartcekur disa herë kanë shkëmbyer mesazhe/email në whatsapp për pagesën, e të cilën debitori nuk e ka kontestuar për nga lartësia dhe as për nga kryerja e punëve, por gjithnjë ka premtuar se do ta paguaj, por që një gjë të tillë nuk e ka bërë deri më sot. Andaj, ka propozuar që refuzohet si i pas afatshëm prapësimi i debitorit, dhe të mbetet në fuqi urdhri i lartcekur i caktuar nga Përmbartuesit Privat, dhe të obligohet debitori që në rast të parashtrimit të ankesës të paraqet dëshminë e pagesës së garancionit siç parashihet me Ligjin e Procedurës Përmbartimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura nr.18-454 e datës 05.07.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm,*

mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Fatura nr.18-454 e datës 05.07.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar tek debitori, pasi që e njëjta nuk mban vulën e pranimin dhe as nënshkrimin e debitorit dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarrim.

Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm, dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1005/22, datë 29.05.2023

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.